



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P. 86/2020

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 26.02.2020, shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e shoqërive “Kadra” sh.p.k dhe “Dajti Park 2007” sh.p.k në procedurën e prokurimit me Nr. REF-44290-11-20-2019, me objekt: *“Blerje buke për Konviktet e Shkollave të Mesme”*, me fond limit 2.523.897 lekë pa tvsh, zhvilluar me date 06.01.2020, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Konvikteve te Shkollave te Mesme.

**Ankimues:** “4 S” sh.p.k  
L. “Xhevdet Nepravishta”, Rr. “Çajupi”, pranë shkollës “L.Kazazi”, Lushnje

**Autoriteti Kontraktor:** Drejtoria e Konvikteve te Shkollave te Mesme.  
Rruga “Jeronim De Rada”, tek ish Konvikti i Ekonomikut, Tiranë

**Subjekte të Interesuar:** “Kadra ” sh.p.k  
Rr. “N.Tereza”, B.Private Nr.P 180/29, Z.K 2372, Laknas, Kamez Tiranë

“Dajti Park 2007” sh.p.k  
L. Qesarake, Godine banimi dhe sherbimesh 3,4 kate, Kati I, Dajt, Tiranë

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim dhe pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## Vëren:

### I

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

### II

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 21.11.2019 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit me Nr. REF-44290-11-20-2019, me objekt: “Blerje buke për Konviktet e Shkollave të Mesme”, me fond limit 2.523.897 lekë pa tvsh, zhvilluar me date 06.01.2020, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Konvikteve të Shkollave të Mesme.

II.2. Në datën 17.01.2020 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht për klasifikimin përfundimtar të ofertave dhe ofertuesit e skualifikuar si më poshtë:

- |    |                          |                              |
|----|--------------------------|------------------------------|
| 1. | “Kadra ” sh.p.k          | 1.610.000 lekë, kualifikuar  |
| 2. | “Dogel” sh.p.k           | 1.624.000 lekë, skualifikuar |
| 3. | “Nelsa” sh.p.k           | 1.736.000 lekë, skualifikuar |
| 4. | “Dajti Park 2007” sh.p.k | 2.212.000 lekë, kualifikuar  |
| 5. | “4 S” sh.p.k             | 2.520.000 lekë, kualifikuar  |

II.3. Në datën 23.01.2020, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, nëpërmjet të cilës kundërshton kualifikimin e shoqërive “Kadra” sh.p.k dhe “Dajti Park 2007” sh.p.k në procedurën e prokurimit. Konkretisht pretendohet si vijon:

*“1- Referuar klasifikimit të publikuar me date 17/01/2020, KVO nuk e ka kryer vlerësimin e ofertave në baze të shumatores së cmimeve për njësi, por në baze të vlerës së përgjithshme të ofertës, e cila bie ndesh me kërkesat e dokumentave standarde të tenderit, të publikuara nga vete AK si dhe me parimet e zhvillimit të procedurës Marreveshje Kuader.*

*2- Operatori KADRA shpk i kualifikuar nga KVO, nuk plotëson kriteret e vecanta të kualifikimit, konkretisht:*

- Piken 1.3.2 të kriterëve të vecanta të kualifikimit. Ky operator nuk disponon Furrë Buke të pajisur me licensën e nënkategorisë II.1.A.1 Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njëzesh leshuar nga QKB, me leje higjieno sanitare, leje mjedisore të tipit C me kodin III.1.A, certifikatën e dezinfektimit 3D si dhe raport analizen mbi përmbajtjen mikrobiologjike të ujit të përdorur në furrë të vlefshme në momentin e hapjes së ofertave.*
- Piken 1.3.4 të kriterëve të vecanta të kualifikimit. Raport analiza e paraqitur nga ky operator nuk i ka treguesit fiziko-kimike (lageshtia, aciditeti, poroziteti, krija) sipas specifikimeve teknike të publikuara në DST.*
- Piken 1.3.7 të kriterëve të vecanta të kualifikimit. Ky operator nuk disponon në pronësi ose përdorim sipas kontratës noteriale 2 (dy) mjete transporti ATP me dokumentacion të vlefshëm në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, të vertetuar me: Leje qarkullimi, siguracion, taksa të mjetit, leje e transportit që leshohet nga Bashkia, kontrolli teknik i mjetit, leje higjienosanitare, dhe certificate pronësie.*

*3- Operatori DAJTI PARK 2007 shpk, i kualifikuar nga KVO, nuk plotëson kriteret e vecanta të kualifikimit, konkretisht:*

- Piken 1.3.2 të kriterëve të vecanta të kualifikimit. Ky operator nuk disponon Furrë Buke të pajisur me licensën e nënkategorisë II.1.A.1 Prodhim, Përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njëzesh leshuar nga QKB me leje higjieno sanitare, leje mjedisore të tipit C me kodin III.1.A, certifikatën e dezinfektimit 3D si dhe raport analizen mbi përmbajtjen mikrobiologjike të ujit të përdorur në furrë të vlefshme në momentin e hapjes së ofertave.*
- Piken 1.3.4 të kriterëve të vecanta të kualifikimit. Raport analiza e paraqitur nga ky operator nuk i ka treguesit fiziko-kimike (lageshtia, aciditeti, poroziteti, krija) sipas specifikimeve teknike të publikuara në DST.*
- Piken I. 3. 7 të kriterëve të vecanta të kualifikimit. Ky operator nuk disponon në pronësi ose përdorim sipas kontratës noteriale 2 (dy) mjete transporti ATP me dokumentacion të vlefshëm në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, të vertetuar me: Leje qarkullimi, siguracion, taksa të mjetit, leje e transportit që leshohet nga Bashkia, kontrolli teknik i mjetit, leje higjienosanitare, dhe certificate pronësie.*

*Sa më sipër kërkojme:*

- Vlerësimin e ofertave në baze të shumatores së cmimeve për njësi.*
- S'kualifikimin e ofertës së paraqitur nga shoqëria KADRA shpk.*

*-S'kualifikimin e ofertes se paraqitur nga shoqeria DAJTI PARK 2007 shpk.*

II.4. NËPËRMJET SHKRESËS NR. 97 PROT., DATË 25.01.20202 AUTORITETI KONTRAKTOR I KA KTHYER PËRGJIGJE ANKIMUESIT DUKE E REFUZUAR ANKESËN SI MË POSHTË:

*"Lidhur me pretendimin e pare ku ju parashtroni se: "1- Referuar klasifikimit te publikuar me date 17/01/2020, KVO nuk e ka kryer vleresimin e ofertave ne baze te shumatores se cmimeve per njesi, por ne baze te vleres se pergjithshme te ofertes e cila bie ndesh me kerkesat e dokumentave standarde te tenderit te publikuara nga vete AK si dhe me parimet e zhvillimit te procedures Marreveshje Kuader", ju sqarojme se, referuar dokumentave te tenderit dhe konkretisht Seksionit 4, Pika 4.2 "Kriteret e perzgjedhjes se fituesit" eshte percaktuar nga ana e autoritetit kontraktor si kriter perzgjedhes "Cmimi me i ulet" dhe nga shqyrtimi i ofertave ekonomike te dorezuara, renditja e tyre eshte e rregullt, sipas Njoftimit te kualifikim/skualifikimi te dates 17.01.2020 nga ana e Komisionit te Vleresimit te Ofertave ne Sistemin Elektronik te Prokurimit, prandaj ky pretendim i juaji nuk qendron .*

*Lidhur me pretendimin e dyte ku ju parashtroni se: "Operatori ekonomik "Kadra" shpk nuk ploteson, Piken 1.3.2 te kriterëve te vecanta te kualifikimit. Ky operator nuk disponon Furre Buke te pajisur me licensen e nenkategorise III 1.A. Prodhim, perpunim, shperndarje me shumice e ushqimeve per njerez leshuar nga QKB, me leje higjeno sanitare, leje mjedisore to lipit C me kodin III I A, certifikaten e dezinfektimit 3D si dhe raport analizen mbi permbajtjen mikrobiologjike te ujit te perdorur ne furre te vlefshme ne momentin e hapjes se ofertave. Piken 1.3.4 te kriterëve te vecanta te kualifikimit. Raport analiza e paraqitur nga ky operator nuk i ka treguesit fiziko-kimike (lageshtia, aciditeti, poroziteti, kripa) sipas specifikimeve teknike te publikuara ne DST", ju sqarojme se referuar dokumentacionit te ofertes te dorezuar nga ky operator ekonomik, rezulton se ka paraqitur te gjithë dokumentacionin e nevojshem per plotesimin e kerkeses se mesiperme per kualifikim si dhe raport analiza per artikullin buke permban analizen per treguesit fiziko-kimike si: lageshtia, aciditeti, poroziteti, kripa, sipas specifikimeve teknike te publikuara ne DST, prandaj ky pretendim i juaji nuk qendron.*

*Lidhur me pretendimin e trete ku ju parashtroni se: "Operatori ekonomik "Kadra" shpk nuk ploteson piken 1.3. 7 te kriterëve te vecanta te kualifikimit. Ky operator nuk disponon ne pronesi ose perdorim sipas kontrates noteriale 2 (dy) mjete transporti ATP me dokumentacion te vlefshem ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi, te vertetuar me: Leje qarkullimi, siguracion, taksa te mjetit, leje e transportit qe leshohet nga Bashkia, kontrolli teknik i mjetit, leje higjenosanitare dhe certificate pronesie", ju sqarojme se referuar dokumentacionit te ofertes te dorezuar nga ky operator ekonomik rezulton se ka paraqitur te gjithë dokumentacionin e nevojshem per plotesimin e kerkeses se mesiperme per kualifikim, prandaj ky pretendim i juaji nuk qendron.*

*Lidhur me pretendimin e katert ku ju parashtroni se: "Operatori ekonomik "Dajti Park 2007" shpk nuk ploteson piken 1.3.2 te kriterëve te vecanta te kualifikimit. Ky operator nuk disponon Furre Buke te pajisur me licensen e nenkategorise III.1.A. Prodhim, perpunim, shperndarje me shumice e ushqimeve per njerez leshuar nga QKB, me leje higjeno sanitare, leje mjedisore te tipit C me kodin III.I.A, certifikaten e dezinfektimit 3D si dhe raport analizen mbi permbajtjen mikrobiologjike te ujit te perdorur ne furre te vlefshme ne momentin e hapjes se ofertave. Piken*

1.3.4 te kritereve te vecanta te kualifikimit. Raport analiza e paraqitur nga ky operator nuk i ka treguesit fiziko-kimike (lageshtia, aciditeti, poroziteti, kripa) sipas specifikimeve teknike te publikuara ne DST", ju sqarojme se referuar dokumentacionit te ofertes te dorezuar nga ky operator ekonomik rezulton se ka paraqitur te gjithë dokumentacionin e nevojshem per plotesimin e kerkeses se mesiperme per kualifikim, si dhe raport analiza per artikullin buke permban analizen per treguesit fiziko-kimike si: lageshtia, aciditeti, poroziteti, kripa, sipas specifikimeve teknike te publikuara ne DST, prandaj ky pretendim i juaji nuk qendron.

Lidhur me pretendimin e peste ku ju parashtroni se: "Operatori ekonomik "Dajti Park 2007" shpk nuk ploteson, Piken 1.3.7 te kritereve te vecanta te kualifikimit. Ky operator nuk disponon ne pronesi ose perdorim sipas kontrates noteriale 2 (dy) mjete transporti ATP me dokumentacion te vlefshem ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi, te vertetuar me: Leje qarkullimi, siguracion. taksa te mjetit, leje e transportit qe leshohet nga Bashkia, kontrolli teknik i mjetit, leje higjenosanitare, dhe certificatepronesie ", ju sqarojme se, referuar dokumentacionit te ofertes te dorezuar nga ky operator ekonomik rezulton se ka paraqitur te gjithë dokumentacionin e nevojshem per plotesimin e kerkeses se mesiperme per kualifikim, prandaj ky pretendim i juaji nuk qendron.

Pas shqyrtimit te pretendimeve tuaja mbi skualifikimin e operatorit ekonomik "Kadra" sh.p.k., dhe operatorit ekonomik "Dajti Park 2007" shpk, Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave gjykon se keto te fundit nuk qendrojne dhe ne kete menyre le ne fuqi vendimin e Komisionit te Vleresimit te Ofertave te dates 17.01.2020 dhe gjendja faktike juridike e operatoreve ekonomik "Kadra" sh.p.k dhe "Dajti Park 2007" shpk mbetet e kualifikuar.

Si perfundirn KSHA lidhur me ankesen tuaj per proceduren e mesiperme te prokurimit ka vendosur: Te mos pranoje ankesen tuaj per proceduren e mesiperme te prokurimit, pasi pretendimet e ngritura nga ana juaj nuk qendrojne."

II.5. Në datën 03.02.2020 operatori ekonomik ankimes ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, me të njëjtin objekt si edhe në autoritetin kontraktor.

II.6. Në datën 11.02.2020 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 136/2 prot., shkresa e autoritetit kontraktor nr. 141 prot., datë 10.02.2020, bashkëngjitur informacioni e dokumentacioni mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit dhe trajtimin e ankesës.

### III

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

#### **Arsyeton**

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik "4 S" sh.p.k se: "Referuar klasifikimit te publikuar me date 17/01/2020, KVO nuk e ka kryer vleresimin e ofertave ne baze te shumatores se cmimeve per njesi, por ne baze te vleres se pergjithshme te ofertes, e cila bie ndesh me kerkesat

e dokumentave standarde te tenderit, te publikuara nga vete AK si dhe me parimet e zhvillimit te procedures Marreveshje Kuader”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në dokumentat e tenderit kjo kontratë është parashikuar të jetë kontratë në bazë të Marrëveshjes Kuadër dhe përshkrimi i saj nga ana e autoritetit kontraktor është: *Loti i parë: “Blerje buke për Konviktet e Shkollave të Mesme”, me fond limit/ vlere te pritshme te kontrates 2.523.897 (dymilion e pesëqind e njëzet e tremijë e tetëqind e nëntëdhjetë e shtatë) lekë pa tvsh.*

Ndërsa në njoftimin e kontratës të dokumentave të procedurës së mësipërme të prokurimit, nga ana e autoritetit kontraktor është përcaktuar si vijon:

*“Kontratat do të lidhen sipas kerkesave te AK, me operatorin ekonomik me te suksesshëm, për secilin lot i cili do te ofroje cmimin me te ulet të ofertës. [...]Në rast të lindjes së nevojës konkrete për të lidhur një kontratë brenda marrëveshjes kuadër, Autoriteti kontraktor i kërkon operatorit ekonomik, fitues të lotit përkatës, të japë ofertën e tij.*

*Komunikimi ndërmjet autoritetit kontraktor dhe operatorit ekonomik, bëhet në formë të shkruar, ose elektronike (e-mail, fax, etj.) dhe në çdo rast duhet të dokumentohet dhe të bëhet pjesë e dosjes së procedurës.*

*Sasitë e parashikuara janë vetëm sasi orientuese dhe NUK e kushtëzojnë Autoritetin Kontraktor për t’i blerë ato. Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të blejë më pak apo më shumë sasi se sa ato të parashikuara (por në çdo rast brenda vlerës së përlllogaritur të marreveshjes kuadër).*

*Kontraktuesi nuk do të ketë të drejtë kompensimi dhe NUK do t’i lejohet të bëjë ndryshime të çmimeve të njësisë, për shembull në rast se autoriteti kontraktor vendos të blejë më pak apo më shumë sasi se sa ato të specifikuara dhe/ose në rast se autoriteti kontraktor vendos të mos blejë asnjë nga këto sasi për disa artikuj.*

*Çmimet për njësi janë përcaktuar në Formularin e Çmimit të Ofertës. Çmimet e njësisive duhet të jenë fikse dhe nuk duhet t’i nënshtrohen ndryshimeve për porositë e vendosura në këtë marrëveshje kuadër.*

III.1.2. Në shtojcën 1 “Formulari i ofertës ekonomike” është parashikuar:

*Loti I “Blerje buke per Drejtorine e Konvikteve te Shkollave te Mesme”*

*Shtojca 1*

*[ Shtojcë për t’u plotësuar nga operatori ekonomik]*

#### **FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE**

*Emri i Ofertuesit \_\_\_\_\_*

*Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]*

*\* \* \**

*Procedura e prokurimit: [lloji i procedurës]*

*Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]*

*Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr.Referencës në faqen e APP-së*

*\* \* \**

*Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:*

1. Çmimi total i ofertës sonë është [monedha dhe vlera e ofertës]; pa TVSH;
2. Çmimi total i ofertës sonë është [monedha dhe vlera e ofertës]; me TVSH

<i>Fondi limit per Lotin e I/ Vlera e pritshme</i>				<i>2.523.897 leke</i>		
<i>Nr.</i>	<i>Pershkrimi i mallrave</i>	<i>Njesi</i>	<i>Sasia e pritshme</i>	<i>Cmimi njesi pa tvsh</i>	<i>Cmimi total</i>	<i>Afati</i>
	<i>LOTI PARE</i>					
<i>1</i>	<i>BUKA</i>	<i>kg</i>	<i>28000</i>			
	<i>Cmimi pa tvsh</i>					
	<i>TVSH 20 %</i>					
	<i>Cmimi me tvsh</i>					

Nënshkrimi i ofertuesit \_\_\_\_\_

Vula \_\_\_\_\_

Shënim:Çmimet duhet të shprehen në Monedhën \_\_\_\_ ( kërkuar në dokumentat e tenderit )

III.1.3. Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 45, pika 2, thuhet shprehimisht:

“Operatorët ekonomikë përzgjidhen si palë të marrëveshjes kuadër duke zbatuar kriteret e përcaktimit të ofertës fituese, sipas përcaktimeve të nenit 55, të LPP-së. Në çdo rast, autoriteti kontraktor mund të vendosë të vlerësojë ofertën/ofertat fituese duke u bazuar në çmimin për njësi”

III.1.4. Nëpërmjet shkresës nr. 97 prot., datë 25.01.20202 autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimesit duke e sqaruar se: “[...] referuar dokumentave të tenderit dhe konkretisht Seksionit 4, Pika 4.2 "Kriteret e përzgjedhjes së fituesit" është përcaktuar nga ana e autoritetit kontraktor si kriter përzgjedhës "Cmimi me i ulet" dhe nga shqyrtimi i ofertave ekonomike të dorëzuara, renditja e tyre është e rregullt, sipas Njoftimit të kualifikim/skualifikimi të dates 17.01.2020 nga ana e Komisionit të Vleresimit të Ofertave në Sistemin Elektronik të Prokurimit, prandaj ky pretendim i juaji nuk qëndron .

III.1.5. Referuar informacionit dhe dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues e autoritetit kontraktor si dhe nga verifikimi i bërë në SPE, rezulton se vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të paraqitura nga ofertuesit për lotin 1 të procedurës së prokurimit “Blerje buke për Konviktet e Shkollave të Mesme”, është bërë bazuar në cmimin total pa tvsh të ofertave të paraqitura nga subjektet pjesëmarrëse. Rezulton se nga ana e autoritetit kontraktor është parashikuar që sasia e pritshme e produktit “Bukë” të jetë 28.000 copë. Për këtë produkt në dokumentat e tenderit është parashikuar fondi limit në dispozicion si dhe janë parashikuar edhe treguesit teknike që duhet të plotësohen lidhur me të, pa lejuar ofrimin e produkteve të tjera apo alternative.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se vlerësimi i ofertave, i kryer nga KVO, referuar cmimit në total, nuk afekton rezultatin dhe renditjen përfundimtare të ofertave edhe nëse ky vlerësim do të kryhej bazuar në shumatoren e cmimin për njësi, pasi në rastin konkret do të prokurohet vetëm një produkt dhe krahasimi i ofertave nuk do të ndryshonte.

Pretendimi i ankimesit nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e ankimuesit se: “Operatori KADRA shpk i kualifikuar nga KVO, nuk ploteson kriteret e vecanta te kualifikimit pasi raport analiza e paraqitur nga ky operator nuk i ka treguesit fiziko-kimike (lageshtia, aciditeti, poroziteti, kripa) sipas specifikimeve teknike te publikuara ne DST”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën 9 “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, pika 1.3.4 e dokumentave të tenderit, rezulton se është parashikuar plotësimi i kushtit si më poshtë vijon:

1.3.4 Operatori ekonomik te paraqesë raportin e analizës se kryer për artikullin buke ne emer te prodhuesit e cila te permbaje te gjithë treguesit e nevojshem fiziko-kimike te leshuar nga laboratore te licensuar nga organet kompetente te leshuar jo me parë se 30 (tridhjete) dite nga hapja e ofertave per artikullin buke (1kg).

III.2.2. Në shtojcën 10 “Specifikimet teknike” është parashikuar si më poshtë vijon:

#### **“1.BUKA**

**Pamja e jashtme:** Të jetë me formë të drejtë dhe e pastër, jo e djegur dhe jo shumë e zbardhur.

**Korja:** Nuk duhet të jetë as shumë e fortë as shumë e butë, me trashesi mesatare.

**Poret:** Duhet të jenë të shpërndara njësoj në të gjithë masën.

**Shija dhe era:** Duhet ti përgjigjet karakteristikës së llojit të bukës, vjen pak si e ëmbël.

Këto tregues përcaktohen me metodën e analizës organo-leptike.

Rrezja e miellit 72-75%

Cilësia Bukë masive e cilësis së parë

Treguesit e bukës në bazë të standartit shtetëror

Pesha e bukës për nje cope 1000 gr

Lageshtia jo më pak se 44%

Aciditeti jo më pak se 3%

Poroziteti jo më pak se 67%

Kripa 1.7-2 %

**Era e shija:** karakteristike e bukës së pjekur

**Pamja e jashtme:** Ngjyre mjalti të kuqe rremtë

Lende të huaja nuk lejohet

Ofertës ekonomike ti bashkanjgjetet raporti i analizës së kryer nga laboratorë të licensuar nga organet kopetente.

**Ambalazhi:** Buka duhet të jetë e prerë me feta dhe e ambalazhuar sipas ligjit në fuqi.

Transporti i bukës bëhet me mjete të pastra të mbrojtura nga dëmtimet dhe faktorët e tjerë atmosferik duke zbatuar rregullat higjeno-sanitare për transportimin e produkteve ushqimorë.

**Produkti ushqimor kur te levrohet duhet të jetë i shoqëruar me flete analizë per treguesit e sigurise dhe cilesise sipas legjislacionit ne fuqi per ushqimin. Te gjithë treguesit organo-leptike dhe fiziko-kimikë te produktit te ofertuar që përfaqësojnë artikullin duhet të përputhen plotësisht me treguesit e shënuar në specifikime teknike dhe standartin shtetëror përkatës. ”**

III.2.3. Nga verifikimi i kryer në SPE rezulton se shoqëria “Kadra” sh.p.k ka paraqitur si më poshtë:



- Raporti i provës nr. 19/5877, lëshuar për kompaninë “Kadra” sh.p.k nga “Bio-V” sh.p.k. Lloji i analizës është: “Vlerësimi i parametrave të cilësisë Bukë”, e cila përmban tabelën e rezultateve të treguesve fiziko-kimike për aciditetin, lagështinë porozitetin dhe kripën si dhe të dhëna plotësuese lidhur me pamjen, aromën dhe shijen e bukës së grurit masive 1 kg. Data e marrjes së kampionit është data 26.12.2019 dhe data e fillimit dhe mbarimit të analizës është data 27.12.2019.

III.2.4. Në nenin 23 pika 1, të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet se : *“1. Specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.*

Në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;”*

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”*

III.2.5. në nenin 27 pika 3 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar parashikohet se *“Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”. Ndërsa në nenin 27, pika 6/c të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar parashikohet se *“Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: c) dëshmi për rezultatet e testeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.”**

III.2.6. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin

ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.2.7. Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, KPP vëren se, autoriteti kontraktor ka kërkuar shprehimisht që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit duhet të paraqesin *raportin e analizës së kryer për artikullin buke në emer të prodhuesit e cila të përmbaje të gjithë treguesit e nevojshëm fiziko-kimike të leshuar nga laboratore të licensuar nga organet kompetente të leshuar jo më parë se 30 (tridhjetë) dite nga hapja e ofertave për artikullin buke (1kg)*. Akoma më tej, autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit ka përcaktuar treguesit e bukës në bazë të standartit shteteror dhe konkretisht ka përcaktuar: Pesha e bukës për një cope duhet të jetë 1000 gr, Lageshtia duhet të jetë jo më pak se 44%, aciditeti jo më pak se 3%, poroziteti jo më pak se 67% dhe kripa 1.7-2 %

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “Kadra” sh.p.k, në përmbushje të kriterit të mësipërm, rezulton se nga ana e tij është paraqitur raporti i provës, lëshuar për kompaninë “Kadra” sh.p.k nga “Bio-V” sh.p.k i cili përmban të dhënat mbi rezultatet e treguesve fiziko-kimike ku rezulton se aciditeti i bukës është 1.8, lagështia 43,85% poroziteti 72,77% dhe kripa në kampion është 1.16 %. Nga katër treguesit në fjalë operatori ekonomik “Kadra” sh.p.k nuk ka plotësuar tre prej tyre e konkretisht aciditetin, lagështinë dhe kripën. Aciditetin dhe lagështinë i ka ofruar në parametra më të ulët se ato të lejuar nga autoriteti kontraktor në DT, (përkatësisht aciditeti të jetë jo më pak se 3% është ofruar 1.8%, lagështia jo më pak se 44% është ofruar 43.85%) dhe kripa nga 1.7-2% e kërkuar është ofruar 1.16%.

Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë dhe përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi, si edhe janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme, si edhe përbën kusht për skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit.

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 66 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se *komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentat e tenderit, si dhe bazuar në nenin 1 dhe nenin 2 të LPP në të cilët përcaktohet përkatësisht: “Qëllimi i këtij ligji është: [...] të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik”;*

*“Përzgjedhja e fituesve të kontratave publike realizohet në përputhje me këto parime të përgjithshme:*

- a) mosdiskriminim dhe trajtim i barabartë i ofertuesve ose kandidatëve;*
- b) transparencë në procedurat e prokurimit;*

c) barazi në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve”, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik “Kadra” sh.p.k nuk plotëson kriterin e vecantë të kualifikimit, lidhur me paraqitjen e raport analizës së produktit “bukë”, në përputhje me specifikimet teknike.

Pretendimi i ankimesit qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimes “4 S” sh.p.k për skualifikimin e ofertës së shoqërisë “Kadra” sh.p.k në procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që pretendimi i mësipërm qëndron, operatori ekonomik “Kadra” sh.p.k nuk përmbush kriteret e kualifikimit dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsyetimit të K.P.P do të jetë e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimese nuk ndryshojnë gjendjen juridike të këtij operatori ekonomik e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

III.4. Lidhur me pretendimin e ankimesit se: “Operatori Dajti Park 2007 shpk i kualifikuar nga KVO, nuk plotëson kriteret e vecanta të kualifikimit pasi raport analiza e paraqitur nga ky operator nuk i ka treguesit fiziko-kimike (lageshtia, aciditeti, poroziteti, kripa) sipas specifikimeve teknike të publikuara në DST”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.4.1. Në shtojcën 9 “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, pika 1.3.4 e dokumentave të tenderit, rezulton se është parashikuar plotësimi i kushtit si më poshtë vijon:

*1.3.4.Operatori ekonomik të paraqesë raportin e analizës së kryer për artikullin buke në emer të prodhuesit e cila të përmbaje të gjithë treguesit e nevojshem fiziko-kimike të leshuar nga laboratore të licensuar nga organet kompetente të leshuar jo më parë se 30 (tridhjetë) dite nga hapja e ofertave për artikullin buke (1kg) .*

III.4.2. Në shtojcën 10 “Specifikimet teknike” është parashikuar si më poshtë vijon:

#### **“1.BUKA**

**Pamja e jashtme:** Të jetë me formë të drejtë dhe e pastër,jo e djegur dhe jo shumë e zbardhur.

**Korja:** Nuk duhet të jetë as shumë e fortë as shumë e butë, me trashesi mesatare.

**Poret:** Duhet të jenë të shpërndara njësoj në të gjithë masën.

**Shija dhe era:** Duhet të përgjigjet karakteristikës së llojit të bukës, vjen pak si e ëmbël.

*Këto tregues përcaktohen me metodën e analizës organo-leptike.*

Rrezja e miellit 72-75%

Cilësia Bukë masive e cilësis së parë

Treguesit e bukës në bazë të standartit shteteror

Pesha e bukës për një cope 1000 gr

Lageshtia jo më pak se 44%

Aciditeti jo më pak se 3%

Poroziteti jo më pak se 67%

Kripa 1.7-2 %

**Era e shija:** karakteristike e bukës së pjekur

**Pamja e jashtme:** Ngjyre mjalti të kuqe rremtë

Lende të huaja nuk lejohet

Ofertës ekonomike ti bashkanjgjetet raporti i analizës së kryer nga laboratorë të licensuar nga organet kompetente.

**Ambalazhi:** Buka duhet të jetë e prerë me feta dhe e ambalazhuar sipas ligjit në fuqi.

Transporti i bukës bëhet me mjete të pastra të mbrojtura nga dëmtimet dhe faktorët e tjerë atmosferik duke zbatuar rregullat higjieno-sanitare për transportimin e produkteve ushqimorë.

**Produkti ushqimor kur te levrohet duhet të jetë i shoqëruar me flete analizë per treguesit e sigurise dhe cilesise sipas legjislacionit ne fuqi per ushqimin. Te gjithë treguesit organo-leptike dhe fiziko-kimikë te produktit te ofertuar që përfaqësojnë artikullin duhet të përputhen plotësisht me treguesit e shënuar në specifikime teknike dhe standartin shtetëror përkatës. ”**

III.4.3. Nga verifikimi i kryer në SPE rezulton se shoqëria “Dajti Park 2007” sh.p.k ka paraqitur si më poshtë:

- Raporti i provës nr. 19/5803, lëshuar për kompaninë “Dajti Park 2007” sh.p.k nga “Bio-V” sh.p.k. Lloji i analizës është: “Vlerësimi i parametrevë të cilësisë Bukë”, e cila përmban tabelën e rezultateve të treguesve fiziko-kimike për aciditetin, lagështinë porozitetin dhe kripën si dhe të dhëna plotësuese lidhur me pamjen, aromën dhe shijen e bukës së grurit massive 1 kg. Data e marrjes së kampionit është data 19.12.2019 dhe data e fillimit dhe mbarimit të analizës është data 20.12.2019.
- Certifikatë analize, lëshuar nga Noval Laboratory për kampionin “Bukë me feta 1000 gr” e cila përmban rezultatet për parametrat kripshmëri, lagështi, ph, porozitet.

III.4.4. Në nenin 23 pika 1, të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet se : “1. Specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

Në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makëneritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;”

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”

III.4.5. në nenin 27 pika 3 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar parashikohet se “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike

*në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”. Ndërsa në nenin 27, pika 6/c të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar parashikohet se “Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: c) dëshmi për rezultatet e testeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.”*

III.4.6. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.4.7. Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, KPP vëren se, autoriteti kontraktor ka kërkuar shprehimisht që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit duhet të paraqesin raportin e analizës së kryer për artikullin buke në emer të prodhuesit e cila të përmbajë të gjithë treguesit e nevojshëm fiziko-kimike të lëshuar nga laboratore të licensuar nga organet kompetente të lëshuar jo më parë se 30 (tridhjetë) dite nga hapja e ofertave për artikullin buke (1kg). Akoma më tej, autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit ka përcaktuar treguesit e bukës në bazë të standartit shtetëror dhe konkretisht ka përcaktuar: Pështia e bukës për një cope duhet të jetë 1000 gr, Lageshtia duhet të jetë jo më pak se 44%, aciditeti jo më pak se 3%, poroziteti jo më pak se 67% dhe kripa 1.7-2 %.

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “Dajti Park 2007” sh.p.k, në përmbushje të kriterit të mësipërm, rezulton se nga ana e tij është paraqitur raporti i provës, lëshuar për kompaninë “Dajti Park 2007” sh.p.k nga “Bio-V” sh.p.k i cili përmban të dhënat mbi rezultatet e treguesve fiziko-kimike të kampionit “bukë” ku rezulton se aciditeti i bukës është 1.8, lageshtia 42,90% poroziteti 72,96% dhe kripa në kampion është 1.7 %. Nga katër treguesit në fjalë operatori ekonomik “Dajti Park 2007” sh.p.k nuk ka plotësuar dy prej tyre e konkretisht aciditetin dhe lageshtinë. Aciditetin dhe lageshtinë i ka ofruar në parametra më të ulët se ato të lejuar nga autoriteti kontraktor në DT, (përkatesisht aciditeti të jetë jo më pak se 3% është ofruar 1.8%, lageshtia jo më pak se 44% është ofruar 42.90%).

Gjithashtu edhe treguesit e analizave të kampionit bukë, të kryera nga Noval Laboratory nuk përputhen me kërkesat e autoritetit kontraktor përsa i përket lageshtisë së bukës e cila ka rezultuar 34.57%, ndërkohë që kërkohet jo më pak se 44% dhe poroziteti i cili duhet të jetë jo më pak se 67% dhe është ofruar 63.82% nga “Dajti Park 2007” shpk.

Pra për të dy kampionet e analizuar asnjëri prej tyre nuk përmbush të gjitha kërkesat e autoritetit kontraktor, parashikuar në dokumentat e tenderit të mësipërm.

Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë dhe përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi, si edhe janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme, si edhe përbën kusht për skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit.

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 66 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se *komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentat e tenderit, si dhe bazuar në nenin 1 dhe nenin 2 të LPP në të cilët përcaktohet përkatësisht: “Qëllimi i këtij ligji është: [...] të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik”*;

*“Përzgjedhja e fituesve të kontratave publike realizohet në përputhje me këto parime të përgjithshme:*

*a) mosdiskriminim dhe trajtim i barabartë i ofertuesve ose kandidatëve;*

*b) transparencë në procedurat e prokurimit;*

*c) barazi në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve”*,

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik “Dajti Park 2007” sh.p.k nuk plotëson kriterin e vecantë të kualifikimit, lidhur me paraqitjen e raport analizës së produktit “bukë”, në përputhje me specifikimet teknike.

Pretendimi i ankimuesit qëndron.

III.5. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues “4 S” sh.p.k për skualifikimin e ofertës së shoqërisë “Dajti Park 2007” sh.p.k në procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që pretendimi i mësipërm qëndron, operatori ekonomik “Dajti Park 2007” sh.p.k nuk përmbush kriteret e kualifikimit dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsyetimit të K.P.P do të jetë i skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimuese nuk ndryshojnë gjendjen juridike të këtij operatori ekonomik e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 *“Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

## **Vendos**

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “4 S” sh.p.k, për procedurën e prokurimit me Nr. REF-44290-11-20-2019, me objekt: “*Blerje buke për Konviktet e Shkollave të Mesme*”, me fond limit 2.523.897 lekë pa tvsh, zhvilluar me date 06.01.2020, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Konvikteve të Shkollave të Mesme.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “Kadra” sh.p.k dhe operatorit ekonomik “Dajti Park 2007” sh.p.k duke i skualifikuar ata.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “4S” shpk.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr. 136 Protokolli**

**Datë 03.02.2020**

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Enkeleda Bega**

**Anëtar**  
**Vilma Zhupaj**

**Anëtar**  
**Lindita Skeja**

**Anëtar**  
**Merita Zeqaj**

**Kryetar**  
**Evis Shurdha**